

VENDIM
Nr.55, datë 2.12. 2004

**PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMEVE TË SHITJES ME PAKICË TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA SHOQËRIA “KESH” SHA PËR KONSUMATORËT FUNDORË
PËR VITIN 2005**

Në mbështetje të ligjit nr.9072 datë 22.5.2003 “Për Sektorin e energjisë elektrike”, neni 8 pika 2 germa b, neni 26 dhe neni 29 të rregullores së praktikës dhe procedurave të ERE-s”, si dhe të procedurave të vendosjes dhe rishikimit të çmimeve në kompanitë e licencuara, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, pasi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga shoqëria KESH-sh.a. për rishikimin e çmimeve të shitjes të energjisë elektrike për vitin 2005 dhe relacionin e Departamentit të Tarifave dhe Çmimeve,

VENDOSI:

1. Çmimet e shitjes me pakicë të energjisë elektrike nga shoqëria “KESH” sh.a. për konsumatorët fundorë për vitin 2005 të jenë sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.
 2. Ngarkohet shoqëria KESH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi me 1 janar 2005 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S

Pjetër Dema

**ÇMIMET E SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE TË APROVUARA NGA ERE
PËR VITIN 2005**

Niveli i tensionit	Kategoritë e konsumatorëve	Cmimi ne leke/kWh
TL	Buxhetorë	8.30
	Jobuxhetorë-Ujësjiellës	6.00
	Jobuxhetorë të tjerë	8.30
	Privatë	8.30
	Media	8.30
	Çmimi mesatar në tension të lartë	8.30
TM	Buxhetorë	9.40
	Jobuxhetorë - Ujësjiellës	7.00
	Jobuxhetorë (nafta, kromi, bakri, plehra kimike, çimento, siderurgji)	8.60
	Jobuxhetorë furnizuar nga TM, matja në TM	10.50
	Jobuxhetorë furnizuar nga TM, matja në TU	11.00
	Privatë të favorizuar-furra buke, prodhime mielli, stacione pompimi vadijtje	7.00
	Objekte kulti	7.00
	Media	9.00
	Privatë furnizuar nga TM, matja në TM	10.00
	Privatë furnizuar nga TM, matja në TU	10.50
	Çmimi mesatar në tension të mesëm	8.62
	Buxhetorë	10.00
TU	Jobuxhetorë-Ujësjiellës	7.50
	Jobuxhetorë (nafta, kromi, bakri, plehra kimike, çimento, siderurgji)	9.50
	Jobuxhetorë furnizuar nga rrjeti TU	12.00
	Privatë të favorizuar-furra buke, prodhime mielli, stacione pompimi vadijtje	7.50
	Objekte kulti	8.00

Privatë të zakonshem	12.00
Media	9.50
Konsumatorët familjarë	5.95
(b) Me sasi të faturuar deri në 210 kWh në muaj	4.50
(e) Me sasi të faturuar mbi 210 kWh në muaj	9.00
Çmimi mesatar në tension të ulët	6.62
Çmimi mesatar i energjisë elektrike për KESH-in	7.01

Shënim: Energjia e përdorur për ambientet e përbashkëta (ndriçim shkallë, ashensor, pompë uji) do të faturohen me çmimin prej 4.5 lekë/kWh.